

## **Bio**

Ka lindur dhe është banues në Tiranë. Si i persekutuar politik, e drejta e arsimit iu dha me fillimet e demokracisë në Shqipëri. Ka studiuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1992 deri në 1998 ka punuar në Arkivin e ish-Ministrit të Brendshme. Më pas ka punuar në arsim, pranë Institutit të të Verbërve në Tiranë. Vijon me publikimin e studimeve të tij me temë historinë e diktaturës së proletariatit në Shqipëri. Ka një sërë botimesh.

## **Punimi**

Njeriu është pjesë e kësaj bote dhe ka detyrime e përgjegjësi për veten e shoqërinë. Si qenie e ndërgjegjshme kemi detyrimin të bashkohemi e të kontribuojmë me më të mirën tonë, për shoqërinë njerëzore. Si një nga të përndjekurit politik unë në vullnetin e dëshirën që kam për të shkruar historinë e persekutimit njerëzor në Shqipërinë komuniste përpiqem të qëmtoj e të jap një pamje reale e objektive të ngjarjes historike të personazhave të mi, kam zgjedhur jo vetëm për të qëmtuar, por dhe të zbuloj shkaqet, pasojat, dhe fatin e viktizimit të tyre, e për të treguar varësinë që ka në një zhvillim historik jo vetëm vullneti personal por dhe vullneti i përgjithshëm i një kombi i nënshtruar nga diktatura. Unë si një nga viktimat e persekutimit komunist ndiej një detyrim moral për të treguar të kaluarën e dhimbëshme të bashkëvuajtësve të mi duke shpresuar se duke rikujtuar në shkrimet e mija ata s'janë më askushi por janë dikushi që me jetën e fatin e dhimshëm të tyre do të tregojnë brezave se ishin dikur në këtë vënd qenje njerzore dinjitoze që respektoheshin e falenderoheshin për kontributin e tyre për kombin, duke shpresuar midis të tjerave që historia e tyre e dhimbëshme të mos përsëritet.

Shkenca ka vërtetuar traumat e pashëruara transferohen në një nivel epigjenetik, familjar, shoqëror dhe kulturor në brezat e ardhshëm.

Teoritë e ndryshme politike i përkufizojnë regjimet diktatorale si antidemokratike të cilat kontrollojnë dhe drejtojnë të gjitha pushtetet brënda shtetit. Filozofi fashist Giovanni Gentile argumentonte se totalitarizmi mbështetej mbi bindjen se “individit dhe shoqëria i përkasin shtetit, i konsideruar jo vetëm si një entitet moral e shpirtëror i aftë të përfaqësoj kombin, por dhe të asimilonte tërësisht degëzimet e ndryshme të shoqërisë civile” te ne si te fashizmi individit dhe shoqëria i përkasinin e duhej të bindeshin enverizmit!

Umberto Eko në shkrimin e tij “Kundër humbjes së kujtesës” viti 2013 shkruan: “Civilizimet nuk mbijetojnë dot pa kujtesën kolektive. Kur ndonjë akt censure përpiqet të zhdukë një pjesë të kujtesës së një shoqërie, kjo shoqëri pëson krizë inditeti. Në një botë në të cilën tentohet të harrohet apo të injorohet shumë, rizbulimi i së shkuarës sonë kolektive duhet të jetë projekti themelor i së ardhmes”

Shërimi nga traumat kërkon rrëfimet e ndigjimin me empati e historive personale, pranimi i emocjoneve dhe ndërmarjen e inisitivave për të rivendosur drejtësi. Vetëm atëhere mund të

ndodhë pajtimi midis persekutorëve dhe viktimave. Në të kundërtën do vazhdojmë të jemi në llogoret tona të betejave.

Kam shkruar një libër me temë kalvarin e një të burgosurit politik, e dërgova për botim në një nga këto institucionet ndërkombëtare që sponsorojnë botime të ish përndjekurëve në Shqipëri, ma refuzuan botimin, e midis vërejtjet të karakterit drejt shkrimor, njëra nga këta nëpunëset që paguhen nga të huajt ndoshta dhe nga taksat e mija midis disa vërejtjeve që janë shumë dytësore në një libër historie, duke më shikuar në sy, me arrogancën e njeriut me pushtet e me një mllef që mezi e fshihnte më tha:- Ju e keni krahasuar komunizmin me nazizmin duhet ta heqësh këtë shprehje nga libri është e papranueshme për mua. Toni i saj me tonalitete të ulta, me sjedhshmëri korrekte ishte gati urdhërues! Kur e thashë: Çfarë ke ti ma lerë mua “mëkatin”! Mu përgjigj preras: Atëhere gjej një shtëpi botuese paguaje dhe botoje librin, këtu haroje!

Ju kujtoj se në datën 25 Janar 2006 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar një rezolutë, me anë të së cilës dënonte krimet e komunizmit duke i cilësuar ato si ekuivalente me krimet e Nazizmit. Fakti që një numër deputetësh votuan kundër rezolutës që dënonte krimet e rregjimeve komuniste dëshmon për vështërsitë e njohjes së kujtesës së fatit tragjik të viktimave të rregjimit komunist.

Gjithashtu Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një rezolutë për dënimin e krimeve të komunizmit në 30 Tetor 2006. Përse për krimet e nazizmin e komunizmit shoqëria Evropiane distancohet prerazi e pa mëdyshje?. Përse për dënimin e krimeve e komunizmin në Shqipëri, nuk e shoh e nuk e ndjej sinqeritetin e ndjeshmërinë adekuate me atë të Evropës për dënimin e krimeve të atij sistemi?

Në përgjigje të frymës enveriste që egziston në shoqërinë shqiptare, po jap medimin tim për këtë temë:

Ashtu si fashizmi, nazizmi, dhe komunizmi vuri në praktikë një shtypje sistematike, deri në ngritjen në momentet kulmore të terrorit si mënyrë qeverisje në Shqipëri. Regjimi komunist për të vendosur pushtetin e tij, ngriti krimin në masë, në një sistem të vërtetë qeverisje, qeveria u perfeksionua në ushtrimin e një shtypjeje të përditshme përmes një censure të plotë të të gjitha mënyrave të komunikimit e eliminimeve të disidentëve. Terrori ka qenë që në fillim një nga tiparet themelore të komunizmit enverist.

Enveristët të vetquajtur komunist menaxhuan mirë një sistem dhune që bazohej në eksperencën Bolshevike në “shtypjen e opozitës dhe përdorimin e gjerë të forcës dhe terrorit për të vendosur dhe ruajtur kontrollin e vendit” e shoqëruar në një nivel shumë të lartë propagandimi, bazuar në eksperencën e nazistit famëkeq Joseph Goebbels që thelbin e frymës së tij e ka “Manipulimi masiv i shoqërisë”. Këto mendësi politike të rregjimit enverist krijuan mundësinë që ata të kishin pushtet absolut në të gjithë fushat e jetës së shoqërisë shqiptare ata përdorën me efikasitet letërsinë, artin, sportin, shkollën, ushtrinë, ndërmarjet ekonomike etj dhe e gjitha kjo në emër të formimit të “njeriut të ri”. Enveristët shqiptar dëshiruan dhe u përpoqën për një shtet të uniformazuar dhe një shoqëri që i bindet verbërisht pushtetit. Ata konstatuan shumë shpejt se dëshira e vullneti i tyre nuk ishte një proces i thjeshtë për tu implementuar në Shqipëri, e kur shoqëria shqiptare reagoi kundër tyre, atëhere ata nuk hezituan të përdornin dhunën shtetërore e partiake. Regjimi komunist në veprimtarinë e tyre për dominim absolut të shoqërisë,

u përballën me opozitën shqiptare të organizuar e të pa organizuar e cila po kundërshtonte kontrollin e plotë të komunistëve mbi gjithë veprimtarinë jetësore të qytetarëve dhe nënshtrimin e tyre. Rezistenca ndaj komunizmit kërkonte trimëri dhe angazhim të jashtzakonshëm. Opozita antikomuniste u përball me egërsinë shtetërore komuniste. Komunistët shqiptar kishin vendosur të eliminonin ligjërisht, por dhe fizikisht, çdo opozitë dhe çdo rezistencë, bile dhe pasive, ndaj pushtetit të tyre hegjemon, jo vetëm kur këta ishin si rezultat i një grupi kundërshtar politik, apo grupeve sociale, si ish paria e vendit, borgjezia, intelijenca, njerëzit e fesë etj por dhe çdo tendence për kundërshtim që shoqëria shfaqti.

Në fillim ata bënë identifikimin e elementëve kundërshtar, e mbi ta u përdorën dhuna fizike, burgjet, kampet e punës së detyruar, izolimi shoqëror, largimi nga strukturat shtetërore e shoqërore, konfiskimi i pasurive personale etj dhunime. Të qenit person i padëshiruar i pa pranueshëm për ta interpretohej e vendosej në bazë të parimeve ideologjike. Ishte partia ajo që indentifikonte elementin që nuk përputhej e nuk pranohej në shoqërinë enveriste, e si i tillë ky individ duhej ti nënshtrohej “riedukimit politik” në burgje, kampet e internimit e dëbimit, në izolimin nga e gjithë shoqëria si qënje e pa denjë, e inferiore për shoqërinë enveriste. Përkrahësit e enverizmit ja mbanin “ison” me devotshmëri!

Ata arritën të tulanin mendimin kritik, mendimin e lirë e pavarur dhe çdo inisiativë antikomuniste, duke imponuar frikën shoqërisë. E gjitha kjo dhunë e organeve ushtarake e partiake u shoqërua me një proces propagandistik të pa shembullt në Shqipëri, qëllimi ishte frikësimi i çdo dëshire për kundërshtim. Shoqëria shqiptare u shpërbë, shumë bashkëpunuan, shumë u strukën të trembur në qoshet e tyre vetmitare të tjerët u përballën dhunshëm me kalvarin e vuajtjeve të tyre.

Dhuna enveriste e pa mëshirshme ra dhe mbi familjet e kundërshtarëve të tyre politik, ku gratë, fëmijët, motrat, vëllezërit e një të dënuari përballej me shumëllojshmërin e persekutimit e një diktature barbare, duke ju mohur të drejtën për punë sipas aftësive, të drejtën për shkollim, izolimin dhe përjashtimin nga mardhënja me pjesën tjetër të shoqërisë, etj dënime, qëllimi ishte që tu krijoheshin vështërsi maksimale si shtresë shoqërore, duke i përbuzur, injoruar, ofenduar, shoqëria shqiptare u drejtua me dhunë drejtë ndarjes racore kur “disa” ishin familje e mirë sepse mbështesnin enverizmin ndërsa “disa të tjerë” familje e keqe sepse ishin kundër enverizmit”. Martesat midis të dy grupeve të shoqërisë shqiptare ishte objekt diskriminimi shoqëror e mbi të gjitha partiak. Kjo shtypje brutale e terrorizoi atë pjesën të popullsisë që nuk ishte aktive në politikë duke e bërë me dëshirë ose pa dëshirë mbështetëse e bashkëpunuese me regjimin duke shpresuar për egzistencën e saj personale. Kjo shtresë shoqërore në instiktin e saj të mbijetesës tregoi mungesë dëshire për të ditur e aq ma pak për tu solidarizuar se çfarë po ndodhte me të vërtetë tek ata të “persekutuarit”, shmangën takimet me fqinjët a ferefis të tyre që u etiketuan nga regjimi me “biografi të keqe” E rëndësishme për këtë shtresë shoqërore ishte mbijetesja e tyre mbijetesja e tjetrit nuk ishte problem i tyre.

Me përmbysjen e sistemit komunist unë si i persekutuar politik u angazhova në një jetë të re, në një ralitë tjetër, ku në pamje të parë unë dukem qënje normale, por thellë në të gjithë qënjen e time dhuna e ushtruar, ka lënë gjurmë të thella te mua. Bisedoj me njerëz të ndryshëm, u tregoj për përpicitë e mija me diktaturën, por e ndjej në shpirt që nuk të kuptojnë, nuk dëshirojnë të më kuptojnë, nuk kanë interes të më kuptojnë. Zgjodha të pranoj që kjo është shoqëria shqiptare, e gjithsesi një zë i mbrëndshëm e instiktiv i fortë më thotë të reagoj të tregoj, të dëshmoj e të kërkoj drejtësi për të vdekurit e të gjallët.

Petro Jorgji Lica i kombësisë greke e shtetësi shqiptare nga fshati Leshnicë e Poshtëme e Sarandës i paralizuar komplet, e zbritën nga kamjoni i shoqëruar me tre polic të armatosur me kallashnikov, i mbartur me një tezgë primitive e ndërtuar me dy hunjë ku i kishin lidhur me lëkurë pemësh, thupra degësh të holla, për shtrojë kishte lëkurë delesh e sipër një nga ato velenxat e leshtë me thekër ngjyrë të zezë tipike të banorëve të Jugut të Shqipërisë, ky i paralizuar armik i partisë që sipas vendimit të Internimit “ kishte tendencë për aratisje” mbahej nga i vëllai Spiro dhe e shoqja e Spiros, mbrapa ju vinte një grua e imët e plakur e gjitha e veshur me të zeza që mbante për dore dy fëmijë të moshës 4-5 vjeç që qanin të tmeruar, e Theodhora kështu e quanin gruan e vjetër nuk haronte të na përshëndeste greqisht të gjithëve ne të internuarit që po shikonim të tmeruar këtë çfaqje makabre. Theodhora i kishin vrarë burrin partizanët në vitet e largëta 1943, tre djemtë e mëdhenj nga frika se mos i vrisnin komunistët ishin aratisur në Greqi, ajo nuk dinte shqip, i ndihmuam për ta sistemuar të paralizuarin në hyrjen që i kishin caktuar dhe i sollëm pak ushqim e ujë sa të sistemoheshin e të parshtateshin me habitatin e ri që enverizmi ju kishte imponuar për të jetuar e dënuar. Më e liga e këtyre njerëzve që kishin pushtet ishte se kur operativi i kampit tonë vinte e na bënte listimin, kur thirrej emëri i Petros dhe i thonim se ai është i paralizuar operativi urdhëronte një policët e ky shkonte te dhoma e Spiros dhe e verifikonte duke ja hequr dhe mbulesat e tij, për të verifikuar a ishte vërtë i paralizuar e kjo përsëritje sa herë që na bëhej apeli i prezencës. E kam të vështirë ti argumentoj vetës në radhë të parë, se përse kishte kaq shumë urrejtje barbare nga këto mekanizma të mjera të enverizmit. Nuk më harohen fjalët e Theodhorës gjysma gjysma greqisht e shqip “Mirë qeveria që nuk na do po Perëdia çka me ne?

Mungesa e tolerancës ndaj shtrese shoqërore antikomuniste ishte gjithë kohës aktive, ishte pjesë e programit të ç'farosjes së kundërshtarëve. Çfaqja e dhunëshme e ekstremitetit të diktatit komunist mbi ta, kishte edhe qëllimin që segmente të lëkundura të popullsisë të frikësoheshin e të mos guxonin ti bashkoheshin antikomunizmit të desidencës shqiptare.

Lufta me diktaturën komuniste është e tmerrshme dhe humbjet janë të mëdha. Në luftë, njerëzit humbasin të dashurit, bëhen të hidhëruar, tjetërsohen. Ata po e përjetonin keq tragjedinë e këtij konflikti mes njerëzve të së njëjtit komb midis enveristëve e të tjerëve Një konflikt që zgjati me dekada. Dhe në të cilin, porosia si të urresh, torturosh dhe vrasësh transmetohet nga një brez në tjetrin. Ne qemë të detyruar të përballëshim ndaj imponimeve të diktaturës për të mbijetuar. Në Shqipëri njerëz të klasave shoqërore dhe pikëpamjeve të ndryshme u ndodhën përballë një fatkeqësie të përbashkët që ishte tej mase absurde. Kjo ishte një luftë ku u përthith bota e të gjallëve nga bota e të vdekurve. Unë si viktimë e pjesmarës në këtë armiqësi, e ndjej dhe e shoh si tragjedinë e brezit tim. Për mua dogma enveriste ishte e dëmshme e pa pranueshme më pengonin në evoluconin e tim normal, më pengonte te zgjohesha frymësisht dhe të jetonja një jetë të plotë në harmoni me botën ku më ra për pjesë të jetoja. Diktatura enveriste arriti të trasformonte një pjesë të shoqërisë shqiptare e cila ndjeshmërinë për të drejtat e qënjeve njerëzore e kishin zero.

Njerëzit e indektrinuar nga enverizmi më urrenin pa e ditur arsyen e vërtetë të urrejtjes, për ta e rëndësishme ishte që partia më urrente, njerëzit më kishin frikë pa arsye, vetëm se partia më cilësonte të rrezikshëm për rendin shoqëror komunist, njerëz që besonin se mundeshin të më kërcënonin e të më hakëreheshin tentonin për të më vendosur në situata ekstreme mbijetese ku ti instiktivisht bëhesh i rrezikshëm për ta, sepse nuk ke se çfarë të humbësh.

Por do vijë gjithmon një ditë kur do ndjesh se dëshiron të ndalesh, kur pesha e persekutimit është shumë e rëndë, ku rruga e dënimeve ska fund, kur gjithçka brënda teje të thotë se nuk ja vlen. Aty është momenti që ti përcakton se çdo kush ecën përpara kur jeta është e lehtë, por fuqia e vërtetë lind në atë moment kur të poshtërojnë e duan të të thyejnë. Aty në dhimbjen e madhe të lind fuqia që se kishe menduar kurrë se të egzistonte. Vendosi të luftosh e të përballesh me të keqen.

Arben Mitri një shok i imi i fëmijërisë sot i vdekur u shkollua në shkollën e sigurimit që në atë kohë ishte në Sauk, unë u dërgova me dhunë në internim. Rasti e solli që Ben Mitri të caktohej operativi i kampit tonë të internimit. Shpresova se shoku im i fëmijërisë do të sillej korrekt me mua, do më lehtësonte peshën e diktatit që kisha në kamp, do i frenonte bashkëpunorët e sigurimit nga provokimet e tyre të shumta, fundja ishim rritur bashkë me të mirë e të keq më njëjtte mirë e gjithashtu dhe unë e njihja mirë kishim hyrë e dalë në shtëpitë e njëri tjetrit. Zhgënjimi që i madh ai përkundrazi duke i haruar miqësitë e vjetra e njohjet që kishte me mua e familjet tona jo vetëm që nuk ma lehtësojë vuajtjen por mbasi refuzimit tim për tu bërë bashkëpunor i tij e i sigurimit të shtetit ai i propozojë organeve përkatëse që unë të ri internohesha dhe 5 vjet të tjera e kështu u bë.

I indoktrinuar nga propoganda enveriste ai nuk ishte i aftë për të kuptuar mendimet dhe idetë që binin ndesh me formimin e tij enverist. Ai u shkollua e u brumos nga enverizmi e besonte se idetë antienveriste jo vetëm që ishin të gabuara por ata që i përkrahnin duhej të heshtnin, të ndëshkoheshin, mandje të çfaroseshin.

Për të e rëndësishme ishte përshtypja e mirë që do kishte enverizmi për të, e jo i të qenurit njëri i drejtë, korrekt e qytetarë i mirë. Ai çfaqte një nivel të ulët empatie për “reaksonarët”. Në diktaturë e ke të vështirë ta kuptosh thelbin e dëshirës për të bërë keq të individëve që afshin e tyre për pushtet e fuqi, e shoqërojnë me urrejtje për të tjerët e ke të vështirë të kuptosh pse shkatërojnë gjithçka nga mardhënjet njerzore, pse bëjnë keq?

Diktatura la gjurmë të thella në psikologjinë e kombit, e keqja e shqiptarëve filloi aty ku ata nuk kundërshtuan, dhunën tjetërsuese, për ta u bë mburojë rehatuese mentaliteti “çdo gjë e të tjerëve është asgjë për mua!”. Shumica e shqiptarëve në diktaturë e kuptonin se ishte e pamundur të jetohej kështu, por bën pak ose aspak për të ndryshuar gjithçka. Kur nuk e di se për çfarë jeton, ti jeton disi, ditë pasdite; ti gëzohesh që kaloi dita, që nata kaloi dhe në gjumë do të zhytesh në pyetjen e mërzitshme pse po e jetoj këtë ditë, pse duhet të jetosh nesër. Vazhdimisht një trishtim për shpresat e pa plotësuar. Ata gradualisht ishin bërë një nga dhëmbëzët e një mekanizëm të madh të “Partisë”, në të cilin gjithçka është e rregulluar rreptësisht; ata ju nënshtruan plotësisht mendësisë së shtetit diktaturë, ku të gjithë duhet të jenë të lumtur dhe mbi të gjitha duhet të tregojnë publikisht se janë të lumtur. Trishtim!

Është e padiskutueshme se bota shpirtërore njerzore është vend luftimi mes së mirës dhe së keqes, dhe është gjithashtu e padiskutueshme se gjithmonë, në çdo rrethanë, edhe gjatë luftës me diktaturën, do të ketë njerëz në të cilët bisha nuk do ta mposhtë njeriun. Njerëzit ndahen në dykategoritë të mëdha: "që kanë të drejtë" dhe "krijesa që dridhen". Të parët janë njerëz që mund të kapërcejnë ligjet morale, kanë personalitet të fortë dhe të dytat janë njerëz të dobët dhe me vullnet të dobët. Sado i madh që ishte dhuna e shkatërrimi i sistemit komunist, shumë njerëz nuk u tmerruan, nuk u friksuan, reagueshan.

Po ju tregoj një histori dashurie që fundin e kishte të hidhur. Adhurimi kushuriri im dhe Dona u dashuruan dhe u martuan. Familja e Donës komuniste e gjitha u hodh në sulm për ta prishur këtë martesë që ja prishte “biografinë” e tyre, dashuria e tyre e përballojë goditjen a para

dhe ata u bënë me dy fëmijë, por hakmarja e komunistave nuk kishte mbaruar Adhurimin e internojnë me motive politike e Dona përsëri nuk pranon të ndahet nga i shoqi, presioni mbi të e Adhurimin nga organet e sigurimit ishte shumë i madh, dëmet e pa fund pasojat lanë gjurmë e kjo familje, mbas rregjimi komunist u shpërbë, ata ikën nga Shqipëria komuniste që jua a nxiu jetën, por goditjet që morën gjatë komunizmit ndikoi në prishjen e kësaj martese me dashuri, ata që përballuan diktaturën me shumë sakrificë, në liri nuk qenë të aftë të mbrojnë dashurinë e tyre.

*Ne ishim të gjithë qenje njerzore që respektonim e respektoheshim. Por metamorfoza politike e Shqipërisë e shkatëroi keq stabilitetin shoqëror të kombit, dhuna komuniste u shtri në të gjitha kapilarët e kombit, në shumë raste dhuna u zbatua brënda lidhjes fisnore, brënda famijeve, brënda njerzëve të një habitati tejet miqësor e po thuajse të gjithë u bënë armik me njeri tjetrin*

Në perceptimin tim, një nga arsytet se përse diktatura enveriste ishte aq e dhunëshme, në ushtrimin e pushtetit të saj është dhe fakti që diktatura gjalloi brutale në shoqërinë tonë, falë kompromiseve e njerzëve që bashkëpunuan me dashje ose pa dashje me të.

Dhe në mbydhje, e di që Enveri nuk është gjallë, por mendësia enveriste mund të mos ekzistojë më si sistem shoqëror, politik dhe ekonomik aktiv, por ajo mbetet ende një forcë aktive psikike që lëviz në sipërfaqe, trashëgimitë dhe kujtimet e atij sistemi ndikojnë në mënyrën se si njerzët vazhdojnë të përfytyrojnë atë që do të ndodhë në të ardhmen. Ne sot në këtë demokraci formale post diktatoriale që kemi ndërtuar, rrezikshëm bashkëjetojmë me *një komunitet të fuqishëm post-enverist e ndajmë me ta një fat të përbashkë për të ardhmen e kombit. Njerz jini vigjilent!*

Fjalor.

Epigjenetik= siç trashëgojmë sëmundjet nga paraardhsit tanë ashtu trashëgojmë dhe traumat, urrejtjen etj

Astrit Jegeni

Tiranë 30.11.2025